



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 715/1 prot.

Tiranë, më 12.06.2024

VENDIM

Nr. 9, Datë 12 / 06 /2024

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE (STAF AKADEMIK DHE STUDENT), PËR ZGJEDHJEN E AUTORITETEVE DREJTUESE DHE SENATIT AKADEMIK, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, të Urdhrit nr. 101, datë 13.03.2024 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Arteve”, miratuar me VSA nr. 17, datë 29.03.2024 si dhe shkresave përkatëse të 3 (tre) fakulteteve të UART, nëpërmjet të cilave përcillen në KIZ listat përfundimtare të votuesve, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, pasi diskutoi mbi to, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare (staf akademik dhe studentë), si trupë zgjedhore në Fakultetin e Muzikës, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Miratimin e listës përfundimtare (staf akademik dhe studentë), si trupë zgjedhore në Fakultetin e Arteve të Bukura, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Miratimin e listës përfundimtare (staf akademik dhe studentë), si trupë zgjedhore në Fakultetin e Artit Skenik, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Ky vendim të dërgohet pranë Komisioneve Zgjedhore të Fakulteteve të Universitetit të Arteve.



5. KZF-të e Fakulteteve pranë Universitetit të Arteve, kanë për detyrë afishimin e listave përfundimtare (staf akademik dhe studentë), në ambientet e secilit Fakultet.
6. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare elektronike të UART.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Orges Malaj



Anëtar

Shpëtim Kërçova

Sekretar
Redjan Mulla




Anëtar

Suela Agolli



Anëtar

Adela Kusuri



Anëtar

Sara Caca

